Org.Jedinica 02
Org Unit
Nr.Prot 05-4786
Broj fajlova
Br.stranica -4-
No.pages
Datum 08/07/2026
Prishtinë / a

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë/Ministry of Health/Ministarstvo Zdravstva

PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE/PSO

EMRI I PSO: DIAGNOSTIKIMI I YERSINIA ENTEROCOLITICA (ITD05/V1.0)

PËRMBAJTJA: DOKUMENTI PËRFSHIN HAPAT KRYESORË PËR KULTIVIMIN, IDENTIFIKIMIN E YERSINIA ENTEROCOLITICA DHE TESTIMIN E REZISTENCËS ANTIMIKROBIKE NË MOSTRËN E FECESIT, DUKE SIGURUAR QË TESTIMI TË KRYHET NË MËNYRË TË SAKTË DHE TË STANDARDIZUAR

VERSIONI: 1.0
DATA E APROVIMIT:07.07.2026
AUTOR: MSH/IKSHPK
NR. I HAPAVE: VI
NR. I NËNHAPAVE: 25

APROVUAR: Jahë Gecaj
U.D. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Shëndetësisë

V.V

REPUBLIKA E KOSOVËS - QEVERIA E KOSOVËS - MINISTRIA E SHËNDETËSISË - REPUBLIKA KOSOVA - VLADA KOSOVA - MINISTARSTVO ZDRAVLJA - REPUBLIC OF KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA - MINISTRY OF HEALTH
Prishtinë / a

QËLLIMI	QËLLIMI I KËSAJ PSO ËSHTË TË SIGUROJË NJË QASJE TË STANDARDIZUAR PËR PROCESET E KULTIVIMIT, IDENTIFIKIMIT E YERSINIA ENTEROCOLITICA DHE TESTIMIN E REZISTENCËS ANTIMIKROBIKE NË MOSTRËN E FECESIT. PROCEDURA E PËRSHKRUAR DUHET TË ZBATOHET NGA GJITHË PERSONELI LABORATORIK.
NDËRLIDHJA ME AKTET	• LIGJI NR. 08/L-200 PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJEVE NGJITËSE, • PLANI STRATEGJIK KOMBËTAR PËR LABORATORE 2024-2030; • DORACAKU PËR MENAXHIMIN E CILËSISË NË LABORATORË; • EUCAST CLINICAL BREAKPOINTS AND DOSING OF ANTIBIOTICS 2026;
LISTA E SHKURTESAVE	• PSO - PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE • PPM - PAJISJET PERSONALE MBROJTËSE • EUCAST- EUROPEAN COMMITTEE ON ANTIMICROBIAL SUSCEPTIBILITY TESTING • ITD- INFEKSIONET E TRAKTIT DIGJESTIV • MALDI-TOF- MATRIX-ASSISTED LASER DESORPTION/IONIZATION TIME-OF-FLIGHT • CIN-CEFSULODIN IRGASAN NOVOBIOCIN

PROCEDURA

Nr.	HAPI	NËN-HAPAT
[I]	Zbatimi i masave për menaxhim të mostrave	1. Mostrën e fecesit e sjellë pacienti ose infermieri i klinikës për pacientët e hospitalizuar dhe dorëzohet në zyrën e pranimit brenda dy orëve pas marrjes nga pacienti; 2. Mostra transportohet nga laboranti në zyrën e pranimit deri në laboratorin për infeksione të traktit digjestiv; 3. Mostra e fecesit, duhet të merret para përdorimit të terapisë; 4. Laboranti kryen pranimin dhe refuzimin e mostrës së fecesit duke i respektuar kriteret e pranimit të mostrës në bazë të Doracakut për Cilësinë e punës në laborator.
[II]	Reagjentët dhe pajisjet që janë të nevojshme për testim	1. Reagjentët dhe pajisjet që janë të nevojshme për testim: **1.1 Reagjentët:** a. NaCl 0.9%; b. Mediumet ushqyese; a. Dorëza Nitrile një përdorimëshe S,M, L; b. Qese Biohazard dhe laps-ngjyrë e përhershme; majë e dyfishtë; c. Pajisjet Personale Mbrojtëse (PPM); **1.2 Pajisjet**: a. Kabineti i biosigurisë niveli II; b. Flaka e Bunsenit; c. Ansa plastike për një përdorim me diametër 0.001 ml; d. Inkubator 37°, O_2; e. Frigorifer 4-8° C dhe -20° C; f. Turbidometri; g. Sistemi identifikues automatik (Vitek, MALDI-TOF); h. Vizorja, matësi i zonës së inhibimit.
[III]	Veprimet laboratorike të marrjes dhe transportit të mostrës	1. Marrja e mostrës së fecesit duhet të jetë e freskët e vendosur në enë sterile; 2. Mbyllet ena sterile me kapak dhe etiketohet me emrin dhe mbiemrin e pacientit; 3. Mostra e fecesit dërgohet sa më shpejtë që është e mundur në laborator; 4. Transporti duhet të bëhet brenda 1–2 orëve nga mbledhja. 5. Nëse ka vonesë më shumë se 2 orë; a. Mostra mund të ruhet në frigorifer 2–8°C. b. Nuk duhet të lihet në temperaturë ambienti për shumë kohë, pasi bakteret mund të shumohen dhe të japin rezultat fals pozitiv.
[IV]	Veprimet e laboratorike	1. Laboranti sigurohet se mediumet për kulturë janë në përputhje me rregullat për kontroll të cilësisë;

	të kultivimit të mostrës	2. Laboranti shënon mediumet me informacionin e numrit identifikues të mostrës (numri i regjistrimit); 3. Laboranti pas hapjen së kontejnerit bën mbjelljen e mostrës (feces) duke përcjellë praktikat aseptike; 4. Mbjellja e mostrës bëhet në mediumin CIN Agar; 5. Pllakat e CIN Agar-it vendosen në termostat sipas kushteve në temperaturë me O_2 37°C.
[V]	Veprimet laboratorike të përpunimit të mostrës pas kultivimit	1. Mikrobiologu ekzaminon pllakat për praninë e rritjes së mikroorganizmit pas inkubimit 24 h dhe identifikon kolonitë bazuar në: a. madhësinë; b. ngjyrën; c. morfologjinë; 2. Vazhdim inkubimi edhe 24 h të tjera në temperaturë dhome (25°C) ; 3. Nëse pas 48 h inkubimi të mostrës kultura ka rezultuar sterile nuk kërkon teste shtesë për përpunim të mëtejmë dhe interpretohet si: **"Pas kultivimit të mostrës në terrenet ushqyese selektive nuk ka rritje të baktereve patogjene".** 4. Nëse mikrobiologu përcakton se kultura ka rezultuar me koloni të dyshimta të bakteries në fjalë, performon testet adekuate për të përcaktuar karakteristikat e bakteries; 5. Kultura pozitive përpunohet në testet standarde biokimike; 6. Sistemet e automatizuara të testeve biokimike për patogjenët e caktuar, në rast se janë dispozicion, mund të përdoren si zëvendësim i veprimit paraprak siç është sistemi i automatizuar (Vitek) për identifikimin e Yersinia Enterocolitikca ose sistemi i specializuar MALDI-TOF; 7. Pas identifikimit final të bakteries kryhet testi i ndjeshmërisë ndaj antimikrobikeve specifik bazuar në EUCAST;
[VI]	Veprimet laboratorike të raportimit të rezultatit	1. Laboranti vendos të dhënat e regjistruara në fletë përcjellëse nga ana e mikrobiologut në sistemin informativ të laboratorit; 2. Laboranti vendos të dhënat në librin e protokollit të laboratorit, respektivisht në data bazat përkatëse të laboratorit; 3. Mikrobiologu verifikon rezultatet mbi saktësinë e analizave të raportuara nga laboranti, të dhënat për patogjenin e identifikuar, testin e ndjeshmërisë në antimikrobikë dhe çdo koment ose rekomandim shtesë.